

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Los Rugrats", krahu i frikshëm i kartelit Sinaloa: Si Gen Z po merr drejtimin e botës së krimit dhe e shfaq në rrjetet sociale
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/los-rugrats-krahu-i-frikshem-i-kartelit-sinaloa-si-gen-z-po-merr-drejtimin--i584160
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 16:17:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 17:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	60abd06784918c5b7f132d54eeb55ba4ac6c7dac35f96f3def7c95040da3eca6
TEKSTI	96b3615245a56217f0f9703cc415de39b9b2f88e21105c7398c2d9a596f7faf5
PAMJA	e209c084d1b4309bc53c6b7225ca9444781d3db81e923ebc54f13aba4737a4cc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	11537cdcc8b01570c881a81aebecdfc2cfbc9918449bfdbf760b249dcbc8d3f9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 46991200
TRANSAKSIONI	0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3
IPFS	QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/11537cdcc8b01570c881a81aebecdfc2cfbc9918449bfdbf760b249dcbc8d3f9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie "U isheh ne tualet", policia jep detaje nga arrestimi i Jozetn MarkutBarcelona zgjedh pese kapitenet per sezonin e ri, surpriza eshte Lamine YamalMuja ve ne veprim "Pla fundit

“Los Rugrats”, krahu i frikshëm i kartelit Sinaloa: Si Gen Z po merr drejtimin e botës së krimit dhe e shfaq në rrjetet sociale



5 Shtator 2026, 19:35Bota TEMA



Emri “Los Rugrats” mund të tingëllojë si diçka e pafajshme, por pas tij fshihet një grup i dyshuar kriminal, i lidhur me kartelin e fuqishëm Sinaloa në Meksikë.

Në qendër të vëmendjes së autoriteteve amerikane është një 30-vjeçar i njohur si “Carlitos Rugrats”, i cili akuzohet për narkoterrorizëm, trafik droge dhe përdorim të dhunës.

Bëhet fjalë për Carlos Paez Pereda, i cili sipas autoriteteve amerikane konsiderohet lideri i dyshuar i grupit “Los Rugrats”. Pseudonimi “Carlitos Rugrats” është një referencë ndaj serialit të animuar të njohur, por aktiviteti që i atribuohet grupit është shumë larg botës së fëmijëve.

Departamenti Amerikan i Drejtësisë e ka shpallur Paez Peredën të kërkuar nga FBI dhe Administrata për Luftën kundër Drogës (DEA).

Autoritetet amerikane e akuzojnë atë për narkoterrorizëm, mbështetje materiale për terrorizmin dhe trafikimin e sasive të mëdha të fentanilit, kokainës dhe metamfetaminës drejt Shteteve të Bashkuara.

Prokurori amerikan Adam Gordon e përmbodhi situatën me një deklaratë të drejtpërdrejtë: “Nuk mund të arrestosh një personazh vizatimor. Por mund të arrestosh një narkoterrorist.”

Dhunë, rrëmbime dhe trafik droge

Sipas hetuesve amerikanë, “Los Rugrats” është një fraksion i dhunshëm që operon në kuadër të rrjeteve kriminale të lidhura me kartelin Sinaloa.

Agjenti special i FBI-së, Mark Remily, ka deklaruar se, pavarësisht emrit të pazakontë, grupi është jashtëzakonisht i rrezikshëm.

Autoritetet pretendojnë se organizata ka përdorur vrasje, rrëmbime dhe armë për të ruajtur kontrollin dhe për të garantuar vazhdimësinë e trafikut të drogës.

Sipas DEA-s. Paez dyshohet se ka kontribuar në përkeqësimin e krizës së drogës në SHBA dhe se ka përdorur dhunën për të mbrojtur aktivitetin kriminal.

Armët e arta dhe jeta luksoze në rrjetet sociale

Një prej elementeve që ka tërhequr vëmendjen e autoriteteve është mënyra se si anëtarë të dyshuar të grupit shfaqnin aktivitetin e tyre në internet.

Departamenti Amerikan i Drejtësisë ka publikuar fotografi të marra nga llogaria e mbyllur në Instagram që lidhet me “Carlitos Rugrats”.

Në disa prej tyre shfaqen armë të personalizuar, me ngjyrë ari dhe argjendi, ndërsa në një fotografi shihet një pistoletë e artë me emrin “Paez” të gdhendur mbi të.

Një tjetër fotografi tregon disa armë të vendosura së bashku, ndërsa një postim i shoqëron ato me mbishkrimin “3 të preferuarat e mia”.

Për autoritetet, këto publikime janë pjesë e një tendence më të gjerë ku persona të lidhur me krimin e organizuar përdorin rrjetet sociale për të ekspozuar pasurinë, armët dhe stilin e jetesës.

“Narko-influencuesit” dhe brezi i ri i krimit

Fenomeni nuk kufizohet vetëm te “Los Rugrats”. Në Meksikë, autoritetet dhe organizatat që monitorojnë krimin e organizuar kanë ngritur shqetësimin për një brez të ri personazhesh të rrjeteve sociale që mund të kenë lidhje me grupet kriminale.

Projekti ACLED ka raportuar se dhjetëra persona me ndikim në rrjetet sociale janë nën hetim për dyshime lidhur me pastrimin e parave për rrjete kriminale.

Sipas të dhënave të cituara nga mediat meksikane, të paktën 19 influencers dhe krijues përmbajtjeje janë vrarë në Meksikë që nga viti 2024.

Maria Fernanda Arocha nga ACLED i ka cilësuar disa prej tyre si “narko-influencues” – persona me një numër të madh ndjekësish që shfaqin një stil jetese luksoz dhe, në disa raste, dyshohet se kanë lidhje me organizata kriminale.

Megjithatë, ajo ka theksuar se lidhjet me grupet kriminale nuk janë të provuara në shumicën e rasteve.

Emoji-t, një gjuhë e re e karteleve

Edhe simbolika në rrjetet sociale është kthyer në një element që po shqyrtohet nga ekspertët.

Sipas raportimeve të mediave spanjolle, disa grupe kriminale përdorin emoji të caktuara si shenja identifikuese ose për të komunikuar me persona që mund të rekrutohen për aktivitete kriminale.

Në përmbajtje të lidhura me Los Chapitos, fraksioni i kartelit Sinaloa i lidhur me djemtë e Joaquín “El Chapo” Guzmán, është vënë re përdorimi i një emoji-je të fetës së picës së bashku me shkronjat “ch”, duke krijuar referencën “chapizza”.

Edhe emoji-ja e gjelit është lidhur në disa raste me Cartel Jalisco Nueva Generación (CJNG) dhe ish-udhëheqësin e tij, Nemesio Oseguera Cervantes, i njohur si “El Mencho”.

Ndërkohë, emoji-ja e kapelës kauboj është lidhur me Ismael “El Mayo” Zambada, një prej figurave historike të kartelit Sinaloa.

Influencuesit që përfundojnë viktimë

Rreziku nuk vjen vetëm nga përdorimi i rrjeteve sociale për ekspozimin e aktiviteteve kriminale. Disa prej influencersve meksikanë janë bërë vetë objektivi i sulmeve vdekjeprurëse.

César Gastélum, 25 vjeç dhe me rreth 600 mijë ndjekës në TikTok, u qëllua për vdekje më 4 gusht, ndërsa po transmetonte drejtpërdrejt nga Sinaloa.

Gastélum ishte i njohur për videot humoristike dhe për paraqitjen e tij me një kapelë kauboj.

Rasti i tij ka ngjallur krahasime me vrasjen e influencerses meksikane Valeria Márquez, e cila u qëllua për vdekje gjatë një transmetimi të drejtpërdrejtë në TikTok.

23-vjeçarja ndodhej në sallonin e saj të bukurisë në Zapopan, në shtetin Jalisco, kur një person i armatosur hyri dhe hapi zjarr.

Vrasja e saj shkaktoi tronditje të madhe pasi gjithçka ndodhi gjatë transmetimit live, para syve të ndjekësve.

Një realitet i ri për kartelet

“Los Rugrats” është vetëm një nga shembujt e mënyrës se si grupet kriminale po përshtaten me epokën e rrjeteve sociale.

Në vend të fshehjes së plotë, disa prej figurave të reja të botës së krimit shfaqin publikisht armët, paratë, makinat luksoze dhe simbolet që lidhen me organizatat e tyre.

Për autoritetet, ky fenomen krijon një problem të dyfishtë: rrjetet sociale shërbejnë njëkohësisht si mjet propagande, rekrutimi dhe, sipas dyshimeve, edhe si kanal për pastrimin e parave.

Ndërsa hetimet ndaj figurave të tilla vijojnë, një gjë është e qartë: brezi i ri i karteleve nuk po e trashëgon vetëm dhunën e paraardhësve, por po e shfaq atë edhe në botën virtuale.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Zbulohet 48-vjeçari i dyshuar për sabotimet ndaj rrjetit energjetik në Gjermani. gjenden pajisje shpërthyes pranë nënstacioneve

17:35 Bota

Meloni feston rekordin e qeverisjes

16:55 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.